



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 75 datë 27.12.2022

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN
DHE DIASPORËN 2023-2025”**

Këshilli bashkiak Shkodër, në mbledhjen e datës 27.12.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 29/1, nenin 54 gërma (k) të ligjit nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; ligjin nr 113/2020 “Për shtetësinë”; ligjin nr. 16/2018 ‘Për diasporën’; ligji nr 79/2021 “Për të huajt”; si dhe relacionin e administratës së Bashkisë Shkodër:

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Planit vendor të veprimit për migracionin dhe diasporën 2023-2025” sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR


Brisela KADIJA

Sekretari i Këshillit Bashkiak


Denis Lesha

Miratuar me 26 vota

Vota Pro 26

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 30.12.2022



Implemented by **giz** Geography & Migration
Implementation
and Monitoring Unit



PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN DHE DIASPORËN 2023-2025



BASHKIA SHKODËR

Plani Vendor i Veprimit për Migracionin dhe Diasporën 2023-2025 u hartua nga:

Grupi i punës

- 1.Stela Mardusha Bashkia Shkodër**
- 2.Deana Alibali Bashkia Shkodër**
- 3.Emirgena Preci Bashkia Shkodër**
- 4.Mirza Berdica Bashkia Shkodër**
- 5.Valmira Guzi Ekspert - Key Adviser**
- 6.Mariel Hysa Ekspert - Key Adviser**

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTIMEVE.....	4
HYRJE	5
METODOLOGJIA	7
KUADRI STRATEGJIK NDËRKOMBËTAR DHE KOMBËTAR.....	9
PLANET VENDORE TË BASHKISË SHKODËR.....	12
PROFILI I BASHKISË SHKODËR.....	14
ANALIZA S.W.O.T.....	17
QËLLIMI I PLANIT VENDOR.....	18
VIZIONI I PLANIT VENDOR TË MIGRACIONIT DHE DIASPORËS	19
OBJEKTIVAT E PLANIT VENDOR SHKODËR	20
PLANI I VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN DHE DIASPORËN 2023-2025	25
MONITORIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT	43

LISTA E SHKURTIMEVE

ADISA	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara
AIDA	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
AKD	Agjencia Kombëtare e Diasporës
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BSH	Bashkia Shkodër
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DHBD	Dhoma e Biznesit të Diasporës
DKM	Departamenti i Kufirit dhe i Migracionit
GCM	Global Compact for Migration
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
INSTAT	Instituti i Statistikave
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
SDG	Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SM	Sportel Migracioni
SMD	Struktura e Migracionit dhe Diasporës

HYRJE

Hartimi i Planit Vendor të Veprimit për migracionin dhe diasporën në Bashkinë Shkodër, është mbështetur nga Programi i GIZ “*Migrimi dhe Diaspora*”, financuar nga Qeveria Gjermane.

Për hartimin e këtij plani janë marrë për bazë parashikimet e kuadrit ligjor kombëtar e vendor, si ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe planet e tjera të përgjithshme apo vendore të Bashkisë Shkodër.

Plani është hartuar bazuar në nevojat që autoritetet vendore kanë, lidhur me ndryshimet e fundit që pësoi ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar. Për këtë arsye, ky plan vendor është një vlerë e shtuar e Bashkisë Shkodër, për të përmirësuar qeverisjen vendore duke përfshirë dhe migracionin e diasporën në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve dhe projekteve që kanë të bëjnë me ta.

Me ndryshimet e fundit në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, konkretisht me ndryshimet e nenit 29/1 të ligjit, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 456 datë.10.06.2020 “Për çështjet, objekt konsultimi dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të këshillit konsultativ të qeverisjes qëndrore me vetëqeverisjen vendore”, shtohen parashikime të reja dhe përcaktohen qartë funksionet e bashkive në fushën e diasporës dhe të migracionit, duke i bërë strukturat përkatëse në nivel vendor, përgjegjëse për kryerjen e funksioneve si vijon:

a) krijimin e strukturës së posaçme për diasporën dhe migracionin, për administrimin e shërbimeve në nivel vendor, si pjesë administrative e

njësisë së vetëqeverisjes vendore;

b) nxitjen e organizimeve, brenda dhe jashtë vendit, për mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm dhe forcimin e marrëdhënieve me diasporën dhe emigrantët shqiptarë;

a) dhënien e ndihmës dhe informacionit për çështje që lidhen me fitimin e shtetësisë shqiptare;

ç) dhënien e ndihmës dhe informacionit për të interesuarit nga diaspora dhe migracioni, për legjislacionin shqiptar në fushën e investimeve, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për çështjet e investimeve;

b) koordinimin e bashkërendimin e punës me ministrinë përgjegjëse për punët e brendshme, për punët e jashtme dhe për diasporën, për garantimin e dhënies së ndihmës e të informacionit për çështjet që lidhen me diasporën dhe migracionin.

Referuar këtyre ndryshimeve ligjore, por edhe situatës aktuale institucionale mbi menaxhimin e çështjeve që lidhen me migrantët e kthyer dhe diasporën, të krijohen struktura dhe politika të përshtatshme në lidhje me migracionin dhe statusin e diasporës shqiptare, kanë një rëndësi kyçe për nxitjen e rritjes sociale dhe ekonomike në Shqipëri. Nëpërmjet zbatimit të politikave të tilla, diaspora do të mund të kontribuojë në mënyrë më efektive në ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe kapitalit financiar, në rritjen e ekonomisë dhe në krijimin e vendeve të reja të punës. Ky plan ofron informacione lidhur me diasporën dhe migracionin dhe nënvizon sfidat dhe mundësitë e pjesëmarrjes më gjithëpërfshirëse të diasporës në përmirësimin dhe zhvillimin e gjendjes ekonomike në vend.

Tematika kryesore e këtij dokumenti lidhet me hartimin e një manuali me objektiva strategjike e masa konkrete, për përfshirjen e migracionit dhe diasporës në procesin e planifikimit të detajuar vendor, si dhe në hartëzimin e aktorëve të interesit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e migracionit dhe diasporës.

METODOLOGJIA

Metodologjia e ndjekur për hartimin e Planit Vendor të Veprimit mbështetet në tre shtylla kryesore si:

Analizimi dhe vlerësimi i nevojave dhe potencialit të targetgrurit, të cilit i adresohet Plani Vendor i Veprimit.



a) vlerësimi i diasporës dhe të rikthyerve në kontekst lokal u realizua nëpërmjet mbledhjes së të dhënave nga spotertelet e migracionit pranë Agjencive

Rajonale të Punësimit dhe Aftësive dhe informacionit pranë institucioneve publike respektive. Analiza bazohet në identifikimin e nevojave dhe ndërlidhja me shërbimet e ofruara nga pushteti vendor.

b) vlerësimi i kapaciteteve institucionale dhe të burimeve njerëzore në nivel bashkie për trajtimin e çështjeve të migracionit dhe diasporës.

Studimi i kuadrit strategjik, ligjor dhe institucional në nivel kombëtar dhe vendor. Vend të rëndësishëm zë e gjithë reforma shtetërore për diasporën, me një paketë të plotë ligjesh. Pjesë përbërëse e kësaj pakete janë po ashtu edhe dy strategji të suksesshme për diasporën dhe baza ligjore e ngritjes dhe funksionimit të institucioneve po ashtu të rëndësishme funksionale për çështjet e diasporës si: Agjencia Kombëtare e Diasporës, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Dhoma e Biznesit të Diasporës.

Në kuadër të mirëqeverisjes së migracionit dhe diaporës u konsultuan dhe Strategjia Kombëtare për Migracionin, ligji “Për të huajt”, ligji “Për shtetësinë”, ligji “Për vetëqeverisjen vendore” dhe aktet nënligjorë të këtij kuadri ligjor, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Zhvillimi i një plani objektivash dhe masash duke mbajtur në konsideratë përputhjen e kuadrit politik, strategjik dhe ligjor me analizën e nevojave konkrete. Rezultatet dhe indikatorët për matjen e tyre janë nëpërputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor të Zhvillimit të Territorit.

Metodat e përdorura:



Krijimi i një grupi pune të dedikuar për hartimin dhe konsultimin e planit, me përbërje nga specialistë të migracionit dhe diaporës, specialistë për çështjet juridike dhe specialistë të kostimit dhe buxhetit në nivel bashkie.

Fokus grupe në nivel vendor, diskutime dhe mbledhja e informacionit në fokus grupe nga institucionet publike në nivel vendor për të dakortësuar fushat e veprimit, objektivat dhe masat.

Konsultimi i Planit Vendor të Veprimit me bashkitë e tjera të pilotuara për hartimin e Planeve Vendore për migracionin dhe diaporën.

Konsultimi publik i Planit Vendor të Veprimit për migracionin dhe diaporën.

KUADRI STRATEGJIK NDËRKOMBËTAR DHE KOMBËTAR

Masat konkrete të parashikuara në planet vendore të veprimit për migracionin dhe diasporën bashkërendojnë me dokumenta strategjikë më të rëndësishëm në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit

Strategjia e Migracionit parashikon koordinimin dhe bashkërendimin e mirë institucional në nivel qendror dhe vendor për zbatimin e politikave të migracionit më qëllim arritjen e objektivave dhe prioriteteve kryesore. Plani vendor i veprimit për migracionin dhe diasporën shtrihet në një linjë veçanërisht me një prej objektivave kryesore strategjikë që është zhvillimi i politikave të efektshme për migracionin për motive punësimi duke rritur ndikimin pozitiv të migracionit tek zhvillimi socio-ekonomik në nivel kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Diasporës dhe Plani i Veprimit 2018-2024

Një dokument tjetër strategjik me të cilin planet vendore të veprimit shtrihen në të njëjtën linjë është Strategjia Kombëtare e Diasporës, e cila ka si qëllim sigurimin e një politike gjithëpërfshirëse për diasporën. Kjo strategji synon mbështetjen e migrantëve që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në mënyrë të ligjshme dhe synon të prodhojë një sintezë të përkushtimit kolektiv të shoqërisë shqiptare ndaj bashkëkombësve që jetojnë jashtë vendit. Po ashtu nxit zhvillimin e politikave shtetërore për përfshirjen dhe kontributin e komuniteteve shqiptare jashtë vendit në zhvillimin socio-ekonomik dhe politik të Shqipërisë.

Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi dhe Plani i Veprimit 2019 - 2022

Planet vendore të veprimit për migracionin dhe diasporën janë në një linjë me një prej prioriteteve kryesore të Strategjisë për Punësim dhe Aftësi siç është: nxitja e përfshirjes sociale dhe kohezionit territorial, nxitja e ri-integrimit në tregun e punës, ngritja e një mekanizmi monitorues, i cili gjurmon kategoritë vulnerabël dhe të përjashtuar nga shoqëria në Shqipëri, duke përfshirë dhe ato që janë prekur nga emigracioni. Planet vendore janë në një linjë dhe me Strategjinë Evropiane të Punësimit 2020, si dhe kërkesave për integrimin evropian të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2016-2020

Planet vendore të veprimit për migracionin dhe diasporën janë në përputhje me vizionin strategjik të SKZHI-së për të krijuar një sistem efektiv të qeverisjes së migracionit në Shqipëri.

Marrëveshja globale për migracionin (GCM-Global Compact for Migration)

Shqipëria ka mirëpritur Marrëveshjen Globale për Migracionin dhe objektivat e saj që në vitin 2018. Planet vendore të veprimit për migracionin dhe diasporën qëndrojnë në një linjë me disa prej objektivave të parashikuar në GCM si: i) Sigurimi i shërbimeve bazike për emigrantët; ii) Fuqizimi i migrantëve dhe shoqërisë për të realizuar përfshirjen e plotë dhe kohezionin social; iii) Krijimi i kushteve për migrantët dhe diasporën që të kontribuojnë plotësisht për një zhvillim të qëndrueshëm në vend.

Axhenda për Zhvillim të Qëndrueshëm SDG (Sustainable Development Goals)

Shqipëria është një nga vendet që ka vendosur Axhendën 2030 si pjesë të prioriteteve të veta kombëtare. Planet vendore të veprimit për migracionin dhe diasporën janë në një linjë me disa prej objektivave të parashikuara në SDG si :

- i) Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë;
- ii) Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit;
- iii) Nxitja e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i mundësisë për drejtësi për të gjithë dhe ngritja e institucioneve të efektshme, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.

PLANET VENDORE TË BASHKISË SHKODËR

Plani i Zhvillimit të Territorit 2015-2030, adreson një nga çështjet kryesore të integritit të migrantëve të kthyer siç është plani i strehimit. Plani i Përgjithshëm Vendor ka si qëllim që ti përshtatet nevojës për strehim duke parashikuar nevojat aktuale për strehim, por edhe duke dhënë mundësinë në të ardhmen për t'u përballur me ndryshime dhe nevoja të paparashikueshme për strehim, ku të tilla mund të jenë rastet e flukseve të migrantëve të kthyer apo diasporës.

Një pikë tjetër lidhëse ndërmjet Planit të Zhvillimit të Territorit dhe Planit Vendor në nivel bashkie për migracionin dhe diasporën, është dhe plani i investimeve kapitale. Duke qenë se një nga synimet kryesore të diasporës/migrantëve të kthyer është dhe investimi në qytetet e tyre, nevojitet garantimi nga ana e bashkisë e mbështetjes për realizimin e investimeve publike dhe private nga diaspora dhe migrantët e kthyer, apo mbështetjes për hartëzimin dhe vendosjen e kontaktit të pushtetit lokal me diasporën/migrantët për hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të projekteve të ndryshme.

Në këtë drejtim, Plani i Investimeve Kapitale të PZHT, ashtu si dhe plani vendor për migracionin dhe diasporën, ka për qëllim instrumentalizimin e mekanizmave të vlefshëm dhe të qëndrueshëm të menaxhimit financiar të përkthyer në projekte kapitale zhvillimi, realizimi i të cilave do të mundësojë: krijimin e lidhjeve të drejtpërdrejta midis projekteve kapitale dhe prioriteteve në kryerjen e shpenzimeve nëpërmjet shpërndarjes efektive të burimeve në dispozicion dhe parashikimit sa më të mirë buxhetor.

Plani Lokal i Veprimit për Rininë 2020-2023, synon hartimin e një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse që do të nxisë zhvillimin e rinie të kulturuar dhe të shëndetshme, që mund të luajë një rol aktiv në

demokratizimin dhe zhvillimin ekonomik vendor. Në veçanti pjesëmarrja e rinisë në jetën publike dhe forcimi i statusit socio-ekonomik të saj përbëjnë një domosdoshmëri për arritjen e standardeve evropiane dhe një ekonomie tregu të aftë për t'u përballur me sfidat e globalizimit.

Plani Social i Bashkisë Shkodër 2018-2021, ka përcaktuar objektivat dhe prioritetet strategjike për një periudhë katër vjeçare me qëllim që të sigurojë dhe ofrojë shërbime të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për mbrojtje, përkujdesje, rehabilitim, përfshirje sociale dhe riintegrim. Autoritetet e qeverisjes vendore kanë një njohje shumë të thellë të problemeve sociale të komuniteteve të tyre, dhe mbajnë përgjegjësi për menaxhimin dhe administrimin e shërbimeve lokale, kështu që ata mund të luajnë një rol kryesor në drejtimin dhe koordinimin e procesit të planifikimit social.

Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore 2018-2020

Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore është një mjet i rëndësishëm i zbatimit në praktikë të angazhimeve publike të ndërmarra nga Bashkia Shkodër në lidhje me parimet e barazisë, planifikimit dhe zbatimit të nevojave dhe të të drejtave të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, si dhe vajzave dhe djemve, nga të gjitha grupet e shoqërisë. Ai u përgatit si hap i parë i zbatimit në praktikë të Kartës Evropiane për Barazi të burrave dhe grave në jetën vendore.

PROFILI I BASHKISË SHKODËR

Bashkia Shkodër shtrihet në veriperëndim të Shqipërisë. Ajo kufizohet në veri me Bashkinë e Malësisë së Madhe, në perëndim me Malin e Zi, në lindje me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Vau i Dejës dhe me Bashkinë Lezhë. Kjo bashki ka në përbërje 11 njësi administrative (*Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Postrinë, Pult, Rrethinat, Shalë, Shosh dhe Velipojë*).

Pozita gjeografike e Bashkisë Shkodër, si qendër ndërlidhëse midis disa bashkive, por edhe ndërkufitare me Malin e Zi, i jep Shkodërs një rol kyç në ofrimin e shërbimeve të sistemit ekonomik, logjistik, arsimor, social e kulturor për të gjithë rajonin dhe komunitetin e Veriut, madje dhe përtej kufirit.

Zhvillimi i përgjithshëm i Bashkisë Shkodër bazohet në ekonominë e industrisë së lehtë prodhuese dhe përpunuese, shfrytëzimin e sistemit hidrik për prodhimin e energjisë elektrike, në biznese të vogla shërbimesh dhe bizneset artizanale. Pjesë e zhvillimit ekonomik të Bashkisë Shkodër janë dhe sektorët e tjerë si bujqësia, peshkimi, industria e tekstilit, lëkurave dhe këpucëve.

Panorama e përgjithshme e Bashkisë Shkodër është edhe më e pasur, pasi përpos zhvillimit të saj ekonomik, Shkodra përfaqëson dhe një djep kulture të hershëm e të veçantë. Ajo përbën një qytet tejet karakteristik për trashëgiminë e vlerave kulturore, të artit, muzikës, krijimtarisë letrare e pamore që mbartin e përcjellin në formën më të bukur vlerat e veçanta të qytetarëve të këtij vendi. Shkodra ka numrin më të madh të poetëve e shkrimtarëve, e njëkohësisht të parët në gjithë Shqipërinë. Falë pozicionit gjeografik kufitar, tokësor dhe detar, Shkodra e ka shfrytëzuar më së miri këtë në drejtim të zhvillimit të rajonit sipas

modelit perëndimor, duke e shfaqur në infrastrukturën e qytetit dhe stilin e jetesës e mendësisë së banorëve të saj. Veprimtaritë e shumta kulturore dhe promovuese, sjellin rrjedhimisht dhe zhvillim ekonomik të saj. Bashkia Shkodër zhvillon një listë të gjatë aktivitetesh e panairesh, me synim promovimin e kulturës dhe traditës Shkodrane brenda dhe jashtë kufijve. Nga më të rëndësishmit për nga pjesëmarrja dhe shtrirja është padyshim “Shkodra Jazz Festival”, i cili bën së bashku artistë të shumtë nga vendi dhe diaspora e Shkodrës dhe Shqipërisë, mbledh bashkë trashëgimtarët e kulturës së vërtetë shkodrane, sjell emigrantë dhe artistë të huaj, duke i përfshirë në angazhime artistike e muzikore përgjatë gjithë javës së zhvillimit të këtij festivali. Ky është një element, i cili jo vetëm promovon zonën në aspektin kulturor e artistik, por ndihmon në ruajtjen e lidhjeve të saj me diasporën dhe vazhdimësinë e traditës. Disa nga aktivitetet e tjera që spikasin dhe që sjellin së bashku qytetarët shkodranë brenda dhe jashtë vendit janë: karnavalet e Shkodrës që zhvillohen çdo vit në muajin shkurt, organizime në çdo fundvit me pjesëmarrjen e orkestrës simfonike të qytetit të Shkodrës, festivali i Fëmijëve, panairi i artizanëve etj.

Ndonëse një rajon me potenciale të lakmueshme e mundësi të mëdha për t’u bërë epiqendra e veriut në aspektin e zhvillimit ekonomik, falë potencialeve natyrore por edhe njerëzore siç është diaspora shkodrane, tejet e pasur dhe e mirë pozicionuar, Shkodra përballlet dhe me sfida e vështirësira të ndryshme. Pavarësisht se në Bashkinë Shkodër ekzistojnë një sërë projektesh për përmirësimin e cilësisë dhe nivelit të jetesës shkodrane, fondet për realizimin e tyre mungojnë. Gjithashtu, diaspora dhe migrantët si një potencial i rëndësishëm në jetën e kësaj zone, nuk janë aq të lidhur sa duhet me vendin e tyre, për shkak të mungesës së infrastrukturës së përgjithshme. Për këtë arsye, ky plan vendor do të shërbejë si dokument bazë për adresimin dhe përmirësimin e sfidave e

problematikave të deritanishme për përfshirjen e diasporës apo riintegrimin e migrantëve të kthyer, me qëllim krijimin e potencialit të nevojshëm për zhvillimin ekonomik e social të Bashkisë Shkodër. Nëpërmjet këtij plani dhe punës së koordinuar të strukturës përkatëse për migracionin dhe diasporën në Bashkinë Shkodër me strukturat e tjera në nivel vendor apo nivel qendror, do të krijohet dhe baza e përditësuar e të dhënave për migrantët e diasporën për të vendosur kontakte të qëndrueshme, me qëllim hartimin e projekteve të ndryshme dhe fasilimitin në shërbimet e nevojshme, me qëllim përfshirjen e tyre në jetën ekonomike, sociale e kulturore të Bashkisë Shkodër.

Për sa i përket shifrave të migrimit të Bashkisë Shkodër ndonëse rezultojnë të jenë të larta, në të njëjtën kohë dokumentohet dhe një numër i konsiderueshëm të kthyerish. Konkretisht struktura e familjeve shqiptare me anëtarë të kthyer që kanë qëndruar jashtë për më shumë se 12 muaj, në Shkodër shënon 4% të rikthyer në vitin 2019, referuar 7.5% që ishte në vitin 2011. Gjithashtu, sipas anketimit të kryer deri më 15 Korrik 2019, numri i të kthyerve për qytetin e Shkodrës është 4,304 individë ose 20 individë për 1000 banorë¹.

¹Anketa Kombëtare e Migracionit në Familje në Shqipëri, 2020, faqe 28, 35, 45
http://www.instat.gov.al/media/7969/zhvillimi_i_anket%C3%ABs_komb%C3%ABtar_e_migracionit_n%C3%AB_familje_alb

ANALIZA S.W.O.T

PIKAT E FORTA

- Përqëndrimi i Institucioneve kryesore në qytetin e Shkodrës;
- Ekzistenca e Sektorit të Planifikimit Strategjik, Integrimit Evropian, Diasporës dhe Migracionit, në strukturën e Bashkisë Shkodër;
- Ekzistenca e institucioneve arsimore (Universiteti i Shkodrës) dhe Institucionet e formimit profesional (Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Shkodër);
- Zhvillimi ekonomik nëpërmjet sistemit hidrik në prodhimin e energjisë elektrike, në prodhimin mineral, industrinë e lehtë prodhuese, industrinë përpunuese, në përpunimin dhe prodhimin e materialeve tekstile, praninë e bizneseve të artizanatit, të cilët kanë një traditë të vjetër në qytetin e Shkodrës,
- Ekzistenca e planeve të tjera sektoriale/vendore
- Hartimi i planeve/ programeve të strehimi, nëpërmjet miratimit të PPVZHT 2015-2013 për Bashkinë Shkodër
- Ndërgjegjësim i ulët për mundësitë e miratimit të Planit të Përgjithshëm Vendor për Zhvillimin e Territorit 2015-2030 për Bashkinë Shkodër;
- Qendër historike për rajonin e veriut me trashëgimi të pasur kulturore dhe artistike;
- Pozicion strategjik i favorshëm për të përfituar fonde. Pozicionimi i mirë i zyrave qëndrore të disa prej programeve ndërkombëtare,

PIKAT E DOBËTA

- Mungësa e një database/të dhënave për migrantët e kthyer dhe kryesisht për diasporën;
- Mungesë stafi/kapacitetesh njerëzore, sidomos të specializuar për ofrimin e shërbimeve të nevojshme apo trajtimin e grupeve vulnerabël;
- Mungësa e kontakteve të pushtetit vendor me diasporën;
- Ndërgjegjësim i ulët për mundësitë e ofrimit të shërbimeve nga strukturat e pushtetit vendor, apo për detyrimet qytetare/publike në pagimin e taksave;
- Mungesa e procedurave standarde për orientimin e dhënies së shërbimeve ndaj migrantëve të kthyer dhe diasporës, apo për mënyrën e kryerjes së investimeve;

MUNDËSITË

- Zhvillimi ekonomik i Shkodrës, i fokusuar në prodhimin e energjisë elektrike, në prodhimin mineral, industrinë e lehtë prodhuese, industrinë përpunuese, praninë e bizneseve të artizanatit, tregtisë, etj;
- Diasporë e pasur dhe me iniciativa për të investuar në vendin e tyre, duke ndikuar në zhvillimin ekonomik, apo migrantët të kthyer që kontribuojnë ekonomikisht apo nëpërmjet integrimit në vendin e tyre njohuritë e situara gjatë jetesës në vendin e destinacionit;
- Ofrimi i arsimit profesional dhe specializimeve të ndryshme për migrantët e kthyer dhe diasporën;
- Projektet e ndryshme on-going për riintegrimin e tyre, ofrimin e shërbimeve të ndryshme, investimet, etj;
- Ekzistenca dhe bashkëpunimi me organizatat jo fitimprurëse apo organizatat ndërkombëtare

KËRCËNIMET

- Mungesa e fondeve për mbështetjen dhe realizimin e planit, që lidhet drejtpërdrejtë me mungesën e ofrimit të shërbimeve dhe investimeve;
- Mungesa e qëndrueshmërisë së projekteve;
- Mungesa e përfshirjes dhe lidhjes së diasporës dhe migrantëve të kthyer me vendin e tyre të origjinës

QËLLIMI I PLANIT VENDOR

Qëllimi i Planit Vendor për Migracionin dhe Diasporën, është që të krijojë dhe fuqizojë infrastrukturën e nevojshme për qeverisjen efektive, koordinimin ndërinstucional dhe orientimin e duhur të diasporës dhe migracionit, duke i bërë faktorë të rëndësishëm në zhvillimin social-ekonomik vendor.

Bashkia Shkodër ofron mundësi të barabarta për qytetarët e saj, pavarësisht vendodhjes së tyre, punon për nxitjen e gjithëpërfshirjes dhe integrimin me të drejta të plota dhe të barabarta të qytetarëve të saj. Përmes këtij plani bashkia ka si mision “të vendosë fokusin tek ofrimi i shërbimeve dhe lehtësirave në realitetin ekonomik-social”.

Qeverisja e mirë dhe garantimi i një zhvillimi të qëndrueshëm janë në themel të asaj çka pushteti vendor duhet të sigurojë për qytetarët. Për këtë nevojitet një përmirësim i vazhdueshëm i menaxhimit të të gjitha burimeve vendore, forcimi i planifikimit strategjik, forcimi i kapaciteteve administrative dhe profesionale të administratës vendore, si dhe rritja e pjesëmarrjes qytetare në proceset vendimmarrëse.



VIZIONI I PLANIT VENDOR TË MIGRACIONIT DHE DIASPORËS



Bashkia Shkodër në 2025 është një qendër kombëtare, një portë e hapur për angazhimin e diasporës shkodrane në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore.

Plani i veprimt të Bashkisë Shkodër si element i rëndësishëm, pasqyron detajimin e funksioneve bazë të sektorëve të ndryshëm të bashkisë për përmbushjen e detyrave.

OBJEKTIVAT E PLANIT VENDOR SHKODËR

Bashkia Shkodër do i realizojë detyrat funksionale dhe ligjore për çështjet e diasporës dhe migracionit, në mënyrë që të arrijë objektivat e parashikuara ne 5 fusha veprimi si më poshtë:

FUSHA E VEPRIMIT	OBJEKTIVAT
A.Menaxhimi institucional vendor i diasporës dhe migracionit	A.1 Forcimi i strukturave vendore nëpërmjet rritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve të burimeve njerezore në instiucionet vendore
	A.2 Koordinimi i aktivitetit me institucionet e pushtetit qendror dhe organizatat ndërkombëtare
	A.3 Bashkëpunimi i organizatave të diasporës me pushtetin vendor
B.Shërbimet sociale dhe publike vendore.	B.1 Informimi i vazhdueshëm për të drejtat dhe detyrimet ligjore
	B.2 Garantimi i shërbimeve sociale për integrimin/riintegrimin e migrantëve të kthyer dhe diasporës
C.Zhvillimi ekonomik vendor	C.1 Identifikimi dhe publikimi për diasporën i nevojave vendore për investime publike
	C.2 Garantimi i mbështetjes për realizimin e investimeve publike dhe private nga

	diaspora dhe migrantët e kthyer
	C.3 Lehtësimi i procedurave për investimet e reja të diasporës dhe mbështetjen e atyre ekzistuese.
D. Veprimtaritë kulturore dhe artistike	D.1 Promovimi i kontributit dhe vlerave të diasporës në fushën artistike dhe kulturore të bashkisë
E. Koordinimi i ndihmës financiare dhe teknike me donatorët	E.1 Vendosja e sistemit për bashkëpunim dhe koordinim të projekteve me përfaqësuesit e organizatave, donatorë dhe ofruesit e shërbimeve

Për realizim sa më efektiv, fushat e veprimit kanalizojnë problematikat dhe proceset e tjera të veprimtarisë së bashkisë në objektiva, të cilat përkthehen në masa konkrete të matshme, të realizueshme dhe të monitorueshme.

FUSHA E VEPRIMIT A:

Menaxhimi institucional vendor i diasporës dhe migracionit, është një proces, i cili realizohet nëpërmjet forcimit të strukturave vendore duke zhvilluar kapacitetet e burimeve njerëzore në institucionet vendore dhe koordinimit të aktiviteteve me institucionet e pushtetit qendror dhe organizata të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare, në mënyrë që të realizohet një urë e qëndrueshme bashkëpunimi me diasporën. Çdo fazë e këtij procesi duhet të kryejë një identifikim real të nevojave konkrete, jo vetëm në bazë trajnimesh dhe kurrikulash për çështjet e diasporës dhe migracionit, por edhe në një nivel më të prekshëm,

duke ndjekur programe të shkëmbimit të eksperiencave në vendet me histori më të pasur në fushën e menaxhimit të resurseve të diasporës.

Në mënyrë që të realizohet koordinimi i duhur dhe efektiv midis institucioneve dhe organizatave, krijimi i databazës së institucioneve qendrore, organizatave ndërkombëtare me detyra funksionale për çështjet e diasporës dhe migracionit, do të lehtësojë këtë proces, duke përcaktuar rrugët e komunikimit për shkëmbimin e të dhënave në mënyrë periodike. Sipas të njëjtit model, por edhe për të krijuar akses më të lehtë, do të krijohet baza e të dhënave për organizatat e komiteteve të diasporës, me një hapësirë të dedikuar në faqen zyrtare të bashkisë. Kjo platformë do të nxisë një ndërveprim të rrjetit të profesionistëve të fushave të ndryshme, bizneseve dhe organizatave të diasporës, nëpërmjet takimeve periodike.

FUSHA E VEPRIMIT B:

Në fushën e shërbimeve publike dhe sociale vendore, ky plan ka objektiva kryesorë informimin e vazhdueshëm të diasporës dhe migrantëve të rikthyer, si dhe garantimin e shërbimeve sociale për integrimin dhe riintegrimin e tyre. Këto objektiva do të arrihen nëpërmjet hartimit dhe shpërndarjes së broshurave informuese, organizimit të fushatave ndërgjegjësuese për shërbimet sociale publike që përfitojnë qytetarët e rikthyer nga migracioni dhe diaspora, si dhe për të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Shërbimet publike sociale vendore, duhet t'ju garantohen subjekteve të këtij plan veprimi, nëpërmjet përfshirjes së punonjësve social të trajnuar në ofrimin dhe referimin për mbështetje në strukturat e posaçme vendore, qendrore apo dhe organizata të shoqërisë civile.

FUSHA E VEPRIMIT C:

Në fushën e zhvillimit ekonomik vendor plani ka objektiva kryesorë: identifikimin dhe publikimin e nevojave vendore për investime publike nga diaspora dhe migrantët e kthyer, garantimin e mbështetjes për realizimin e këtyre investimeve publike, si dhe lehtësimin e procedurave për kryerjen e tyre.

Realizimi i këtyre objektivave do të arrihet nëpërmjet promovimit të të gjitha planeve strategjike të Bashkisë Shkodër, në mënyrë që të realizohet procesi njohës i nevojave për investime në përputhje me parashikimet në strategji më gjithpërfshirëse, duke respektuar përcaktimet e ndryshme ligjore. Këto procese njohëse do të kryhen nëpërmjet takimeve, konferencave të ndryshme më të gjithë aktorët e përfshirë, duke ju parashtruar informim dhe këshillim mbi kuadrin ligjor, institucional për zhvillimin e investimeve në Shqipëri.

Realizimi i investimeve në këtë kontekst, do të kryhet më së miri nëpërmjet përcaktimit të një procedure më të thjeshtuar për donacionet nga diaspora, duke ofruar asistencë për plotësimin e dokumentacionit për aplikim, si dhe duke aplikuar masa lehtësuese në të gjitha fazat.

FUASHA E VEPRIMIT D

Në fushën e veprimtarive kulturore dhe artistike, ky plan ka objektiv kryesor promovimin e kontributit dhe të vlerave të diasporës në një nivel gjithpërfshirës. Objektiv, i cili do të realizohet nëpërmjet organizimit të aktiviteteve, koncerteve, panairove, me pjesëmarrjen e diasporës, si dhe realizimin e vizitave të ndryshme për mbrojtjen e identitetit dhe kulturës shqiptare në komunitetet shqiptare të diasporës.

FUSHA E VEPRIMIT E

Fusha e koordinimit të ndihmës financiare dhe teknike me donatorët, do të realizohet dhe përmirësohet nëpërmjet vendosjes së një sistemi për bashkëpunim dhe koordinimin të projekteve me përfaqësuesit e organizatave, donatorët dhe ofruesit e shërbimeve. Një sistem i tillë do të ndihmojë dhe subvencionojë biznese të reja nëpërmjet një granti të dedikuar. Gjithashtu, ky objektivi do të arrihet nëpërmjet hartëzimit dhe vendosjes së kontaktit me të gjitha projektet e diasporës dhe migracionit dhe organizatat që do ti implementojnë ato.

Një databazë me të gjitha projektet dhe organizatat implementuese, do të lehtësojë dhe do të realizojë koordinimin e aktiviteteve ndërmjet organizatave dhe bashkisë, si dhe do të realizojë më së miri shkëmbimin e informacionit mes tyre.

PLANI I VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN DHE DIASPORËN 2023-2025

Fusha e veprimit		Rezultati në fushën e veprimit:					
A. Menaxhimi institucional vendor i diasporës dhe migracionit	1. Fuqizimi i strukturës së migracionit dhe diasporës në nivel vendor 2. Rritja dhe zhvillimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore për migracionin dhe diasporën 3. Krijimi i mekanizmave koordinues dhe bashkëpunues me pushtetin qendror, organizatat e shoqërisë civile, komunitetin e diasporës dhe të rikthyerit nga migracioni.	Masat	Periudha e zbatimit	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Rezultate e pritshme	Indikatorët e monitorueshëm
		Objektivi J.1 Forcimi i struktura ve vendore nepërmjet rritjes dhe	a) Identifikimi i nevojave trajnime dhe hartimi i një kurrikule trajnime për administratën e bashkisë për çështjet e diasporës dhe migracionit	2023-2025	SMD/BSH	AKD ASPA OSHC Dr. BNJ	1. Raport mbi nevojat e identifikuara 2. Hartimi i kurrikulës

zhvillimit të kapaciteteve tëburimeve njëzore në institucionet vendore	b) Organizimi dhe pjesëmarrja në trajnime periodike mbi migracionin dhe diasporën për administratën e bashkisë	2023-2025	SMD/BSH	Dr. BNJ AKD ASPA OSHC Donatorë	1.Realizimi i trajnimeve	1.Numri i trajnimeve tërealizuara 2.Numri i të trajnuarve
	c) Shikëmbimi i ekspertencave me vendet eksperte të menaxhimit të resurseve të diasporës ne rajon dhe me gjerë	2023-2025	SMD/BSH	AKD OSHC Donatorë	1.Realizimi i vizitave studimore	1.Numri i vizitave studimore të realizuara 2.Numri i personave që kanë marrë pjesë nga BSH

	d) Promovimi i strukturës së diasporës dhe migracionit	2023-2025	SMD/ BSH		1. Realizimi i aktiviteteve promovuese dhe informuese për shërbimet që ofron struktura 2. Fletëpalosje 3. Fushata informimi	1. Numri i aktiviteteve 2. Numri i qyterarëve të informuar
Objektivi 1.2: Koordinimi i aktiviteteve me institucionet e pushtetit	a) Krijimi i databazës së institucioneve qendrore, organizatave ndërkombëtare me detyra funksionale për çështjet e diasporës dhe migracionit	2023	SMD/BSH	AKD/AM MV	1. Krijimi i një databaze dhe përditësimi periodik i saj	1. Institucionet organizatat e identifikuar

qendror dhe organizatat ndërkombëtare	b) Organizimi i 2 takimeve në vit me institucionet qendrore dhe organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare	2023-2025	SMD/BSH	AKD/AM MV	1. Vendosija e pikave të kontaktit 2. Marrëveshje bashkëpunimi	1. Numri i takimeve të realizuara 2. Çështjet e trajtuara
Objekti 1.3: Zhvillimi i bashkëpunimit me organizatat,	c) Përcaktimi i modaliteve të komunikimit për shkëmbimin e të dhënave	2023-2024	SMD/BSH	AMVV/ AKD	1. Shkëmbimi i vazhdueshëm i të dhënave me strukturat në nivel qendror	1. Numri i komunikimeve /shkëmbimeve të informacionit
	a) Krijimi i një databaze të organizatave /komuniteteve të diasporës	2023	SMD	AMVV AKD	1. Databaza me organizatat/komunitetet e diasporës	1. Numri i organizatave të identifikuar

komunitetet dhe profesionistët e lirë të diasporës	b) Krijimi i një hapësire të dedikuar online për diasporën në faqen zyrtare të bashkisë	2023-2025	SMD Drejtoria IT	AMVV AKD OSHC	1. Aplikacioni/ Platforma online	1. Numri i personave/organizatave nga diaspora të regjistruar në platformën online
	c) Realizimi i takimeve periodike me rrjetin e profesionistëve të fushave të ndryshme, biznese dhe organizatave të diasporës.	2023-2025	SMD Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit	AMVV AKD OSHC	1. Realizimi i takimeve 2. Konsolidimi i memorandumeve të bashkëpunimit	1. Numri i takimeve të realizuara; 2. Numri i memorandumeve/marrëveshjeve të lidhura
Fusha e veprimit B. Shërbimet publike dhe	Rezultate në fushën e veprimit: Rritja e përfshirjes së diasporës dhe të të rritshërve në skemat e shërbimeve sociale publike					

socialle vendore	Masat	Periudha e zbatimit	Institucioni pergjegjes	Institucioni mbeshitetes	Rezultatet e pritshme	Indikatorët e monitorueshëm
Objektivi 2.1: Informimi i vazhdueshëm i diasporës dhe migrantëve të rikthyer për të drejtat dhe detyrimet ligjore	a) Krijimi i një database të qytetarëve të rikthyer nga migracioni	2023-2025	SMD/	AKPA AMVV AKD	1.Database për migrantët e kthyer	1.Numri i qytetarëve të rikthyer nga migracioni të identifikuar
	b) Hartimi i një broshure informuese/ integrimi ne website-n zyrtar të bashkisë për shërbimet sociale/publike që përfitojnë qytetarët e rikthyer nga migracioni	2023-2025	SMD/DSHS	AKPA AMVV AKD OSHC	1.Broshure informuese/ integrimi ne website-n zyrtar	2.Numri i broshurave informuese

	<p>c) Zhvillimi i fushatave ndërgjegjëse për informimin e migrantëve mbi të drejtat dhe detyrimet</p> <p>d) Integrimi në struktural e shërbimeve sociale në territor të tematikave për këshillimin e migrantëve të rikthyer; apo tematikave për parandalimin e emigrimit (sidmos atij të paligjshëm).</p>	2023-2025	SMD/DSHS		I. Fushata informimi dhe ndërgjegjësimi	I. Numri i qytetarëve të informuar
		2023-2025	SMD/DSHC		I. Ofrimi i këshillimit	I. Numri i takimeve të zhvilluara

Objekti 2.2: Garantimi i shërbimeve sociale për integrimin/riintegrimin e migrantëve të kthyer dhe diasporës	a) Përfshirja e punonjësve social në trajnimet për trajtimin e migrantëve të kthyer; koordinimi i tyre me organizatat	2023-2023	SMD/DSHS		1. Hartimi i programeve të trajnimit	1. Numri i stafit të trajnuar
	b) Referimi i rasteve pranë institucioneve/drejtorive/strukturave të tjera vendore, në varësi të nevojës apo shërbimit të kërkuar.	2023-2025	SMD/DSHS		1. Rastet e referuara	1. Numri i rasteve të referuara
Fusha e veprimit	Rezultatet në fushën e veprimit:					
C. Zhvillimi ekonomik vendor	Investimet publike dhe private nga diaspora kanë rritur zhvillimin ekonomik vendor					
	Masat	Periodha e zbatimit	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Rezultatet eprishme	Indikatorët e monitorueshëm

Objekti 3.1: Identifikimi dhe publikimi per diasporen i nevojave vendore per investime publike	a) Promovimi i planeve strategjike të Bashkisë Shkodër	2023-2025	BSH SMD	AKD DHBD	1. Aktivite promovuese të zhvilluara 2. Materiale promovuese të prodhura	1. Numri i fushalave të promovimit për fushat e zhvillimi ekonomik, turizëm, shërbime sociale, mjedis, kulture, rini dhe sporte, etj. 1. Numri i materialeve promionale të publikuara
	b) Azhormimi i materialeve promionale me fokus diaporën.	2023-2025	BSH SMD	AKD DHBD	1. Publikimi i materialeve promionale	

	c) Organizimi i konferencës së diasporës për promovimin e planeve strategjike të Bashkisë Shkodër.	2023-2025	BSH SMD	AKD DHBD	I.Konferenca	I. Numri i pjesëmarrësve në konferencë
	d) Organizimi i takimeve B2B me bizneset vendore dhe të diasporës.	2023-2025	BSH SMD	AKD DHBD	I.Eventi	I. Numri i bizneseve pjesëmarrëse

Objekti 3.2: Garantimi i mbështetjes për realizimin e investimeve publike dhe private nga diaspora dhe migrantët e kthyer	a) Informim dhe këshillim mbi kuadrin ligjor, institucional për zhvillimin e investimeve në Shqipëri/Përditësimi i dokumentave informues.	2023-2025	BSH SMD	AIDA AKD DHBD	1. Dokumenti informues	1. Paketa informuese; 2. Numri i dokumentave
	b) Hartimi i një procedure standarte për zhvillimin e investimeve publike me donacione nga diaspora.	2023	BSH SMD	AKD DHBD	1. Miratimi i procedurës standarte	1. Numri i investimeve
	c) Ndjekja e aplikimeve, monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të investimeve publike.	2023-2025	BSH SMD		1. Raportet e monitorimit	1. Numri i projekteve të realizuara

<p>Objektivi 3.3: Lehtësimit i procedurave për investimet e reja të diasporës dhe mbështetjen e atyre ekzistuese.</p>	<p>a) Analizimi dhe rivlerësimi i nivelit të taksave dhe tarifave në nivel vendor dhe procedurave të shlyerjes</p>	<p>2023-2025</p>	<p>Drejtorin e Financave/S MD</p>	<p>DHBD</p>	<p>1. Ujje e taksës së pronës (ndërfesës dhe tokës bujqësore). 2. Shlyerja edetyrimit me këste, çdo muaj për bizneset dhe familjet. 3. Përcaktimin e nivelit të tarifës sipas llojit të aktivitetit. 4. Përcaktimi i nivelit të tarifës sipas vendndodhjes gjeografike</p>	<p>1. Numri i iniciativave të lançuara; 2. Numri i bizneseve përfutuese 3. Miratimi i KB</p>
--	--	------------------	-----------------------------------	-------------	--	--

	b) Azhormimi i paketave informuese në lidhje me programet dhe skemat e ndryshme financiare për të cilat mund të jenë të interesuar subjektet e ndryshme.	2023-2025	Drejtoria e Financave/S MD	DHIBD	I. Paketat informuese	I. Numri i paketave
	c) Asistenca për plotësimin e dokumentacionit për aplikim.	2023-2025	SMD		I. Ofrimi i asistencës Teknik	I. Numri i subjekteve të asistuar
Fusha e veprimit D. Veprimtari të	Rezultate në fushën e veprimit: I. Diaspora dhe migrantët e kthyer janë pjesë integrale dhe e vazhdueshme e jetës kulturore, artistike në Bashkinë e Shkodrës					

2. Kultura dhe arti shkodran kanë arritur të shfaqen në diasporën shqiptare							
kulturore dhe artistike	Masat	Periudha e zbatimit	Institucioni përgjegjës	Institucion i mbështetës	Rezultatet e pritshme	Indikatorët e monitorueshëm	
Objektivi 4.1: Promovimi i kontributit dhe vlerave të diasporës në fushën artistike dhe kulturore të bashkësë	a) Organizimi i aktiviteteve, koncerteve, panairëve, me pjesëmarrjen e diasporës	2023-2025	SMD	AKD	1. Aktivitete të ndryshme brendadhe jashtë 2. Java kulturore e diasporës	1. Numri i aktiviteteve	
	b) Realizimi i vizitave përmbrojtjen e identitetit dhe kulturës shqiptare në komunitetet shqiptare të diasporës	2023-2025	SMD	AKD	1. Aktivitete të ndryshme brendadhe jashtë	1. Numri i vizitave të realizuara; 2. Numri i materialeve promovionale	
Fusha e veprimit E. Koordinimi i	Rezultate në fushën e veprimit: Projekte të koordinuara nga bashkia Shkodër sipas nevojave vendore për investime, me donatorët dhe organizatat e shoqërisë civile.						

ndihmës financiare dhe teknike me donatorët	Masat	Periudha e zbatimit	Institucioni përgjegjës	Institucioni përgjegjës	Rezultatet e pritshme	Indikatorët e monitorueshëm
Objekti S.1: Vendosja e sistemit për hashkëpunim dhe koordinimin të projekteve me përfaqësuesit e organizatave, donatorë dhe	a) Subvencionimi i bizneseve të reja nëpërmjet një granti të dedikuar.	2023-2025	SMD	DHBD AKD	1. Grant i dedikuar	1. Numri i iniciativave të lançuara; 2. Numri i bizneseve përfutuese 3. Miratimi i KB
	b) Hartëzimi dhe vendosja e kontaktit me të gjitha projektet e diasporës dhe migracionit	2023-2025	SMD	DHBD AKD Donatorë	1. Aplikacion/ Platforme online	1. Numri i projekteve të identifikuara

ofruesit e shërbimeve.	c) Krijimi i një databaze me të gjitha projektet dhe organizatat që do të implementojnë ato.	2023-2025	SMD	AKD	I.Database i krijuar	I.Numri i identifikuar i projekteve
	d) Koordinimi aktivitetesh ndërmjet organizatave dhe strukturës përgjegjëse për migracionin dhe diasporën në bashki dhe shkëmbimi i informacionit.	2023-2025	SMD	AKD	I.Organizimi i takimeve periodike	I.Nr i aktivitetesh të realizuara
	e) Hartimi, aplikimi, zbatimi i projekteve të përbashkëta me fokus migracionin dhe diasporën.	2023-2025	SMD		I.Realizimi i projekteve	I.Numri i projekteve të realizuara

	<p>e) Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të projekteve dhe asistencës teknike.</p>	<p>2023-2025</p>	<p>SMD</p>		<p>1. Realizimi i raportit të monitorimit dhe vlerësimit</p>	<p>1. Numri i raporteve të kryera 2. Shkalla e realizimit të tyre</p>
--	---	------------------	------------	--	--	---

MONITORIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT

Progresi në arritjen e objektivave do të matet nëpërmjet indikatorëve, të lidhur me objektiva dhe masa specifike, siç përcaktohet në Planin e Veprimit. Përgjegjësia për monitorimin e përfundimit në kohë të secilës masë dhe sipas parashikimit, do të qëndrojë në një drejtori udhëheqëse, e cila ka në fushën e saj të përgjegjësisë çështjet e migracionit dhe diasporës.

Monitorimi i progresit të zbatimit të Planit të Veprimit do të kryhet nëpërmjet hartimit të raportimeve 6 mujore nga drejtoritë përgjegjëse për zbatimin e masave. Raportimet 6 mujore do të ndahen një herë në vit me gjithë institucionet lokale, qendrore dhe organizatat në një konferencë të organizuar nga bashkia.

Gjetjet dhe rekomandimet mbi ecurinë e Planit të Veprimit adresohen në mbledhjet e Këshillit Bashkiak.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 75 datë 27.12.2022

“PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN
DHE DIASPORËN 2023-2025”

Këshilli bashkiak Shkodër, në mbledhjen e datës 27.12.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 29/1, nenin 54 gërma (k) të ligjit nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; ligjin nr 113/2020 “Për shtetësinë”; ligjin nr. 16/2018 “Për diasporën”; ligji nr 79/2021 “Për të huajt”; si dhe relacionin e administratës së Bashkisë Shkodër:

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Planit vendor të veprimit për migracionin dhe diasporën 2023-2025” sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR


Brisela KADAJA

Sekretari i Këshillit Bashkiak


Denis Lasha

Miratuar me 26 vota

Vota Pro 26

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 30.12.2022